

VENDIM
Nr. 323, datë 14.7.2022

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
ELBASAN**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”.

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 14.7.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

KONSTATOI SE:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 55, datë 28.10.2019, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan sh.a.”, për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 3474 prot., datë 30.6.2022, me lëndë: “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Elbasan është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendorsjes së Tarifave.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Elbasan është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 539, datë 30.12.2021, dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan, për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan dhe Bashkinë Elbasan, për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani